

URDHËR
Nr. 635, datë 13.9.2012

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË URDHRIN NR. 83, DATË 10.2.2012 “PËR RREGULLAT DHE PROCEDURAT E SHITJES SË PRODUKTEVE HIDROKARBURE (NAFTË BRUTO)”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 1 të aktit normativ nr. 2, datë 18.6.2010 “Për një shtesë në ligjin nr. 7746, datë 28.7.1993 “Për hidrokarburet (kërkimi dhe prodhimi)”, të ndryshuar, miratuar me ligjin nr. 10 298, datë 8.7.2010, ligjit nr. 9874, datë 14.2.2008 “Për ankandin publik”, të ndryshuar, si dhe vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 1719, datë 17.12.2008 “Për miratimin e rregullave të ankandit publik”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

Në urdhrin nr. 83, datë 10.2.2012 “Për rregullat dhe procedurat e shitjes së produkteve hidrokarbure (naftë bruto)”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

1. Paragrafi i parë i urdhrit riformulohet:

“Shoqëria “Albpetrol” sh.a. Patos përcakton sasinë dhe cilësinë e produktit hidrokarbur (naftë bruto) që do të shitet për tregun vendas dhe/ose për eksport, sipas procedurave të këtij urdhri.”.

2. Pika 1 riformulohet:

“1. Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës (METE), mbi bazën e njoftimit të shoqërisë “Albpetrol” sh.a. Patos miraton shitjen me ankand të produkteve hidrokarbure (naftë bruto) për tregun vendas me qëllim përpunimin e tyre dhe/ose për eksport.

Shitja me ankand të bëhet me anën e procedurës së hapur.”.

3. Pika 3 riformulohet:

“3. Me krijimin e sasisë së përcaktuar në pikën 2 të këtij urdhri, ministri nxjerr urdhrin për shitjen me ankand me anën e procedurës së hapur të kësaj sasive produkti hidrokarbur (naftë bruto).”.

4. Pika 4 riformulohet:

“4. Në urdhër përcaktohet:

- sasia e produkteve hidrokarbure (naftë bruto), që do të shitet;
- çmimi/njësi fillestar i ankandit;
- procedura e hapur;
- emrat e anëtarëve të komisionit të shitjes dhe të njësisë së ankandit.

Njësia e ankandit përbëhet nga 5 (pesë) anëtarë, 2 (dy) nga të cilët nga shoqëria “Albpetrol” sh.a., 2 (dy) nga METE dhe 1 (një) nga IQT.

Ky urdhër do të hartohet nga struktura përgjegjëse në METE.

Një kopje e këtij urdhri dërgohet për njoftim në shoqërinë “Albpetrol” sh.a. Patos.”.

5. Pika 7 riformulohet:

“7. Për nxjerrjen e të dhënave sipas pikës 6, krijohet grup ekspertësh të fushës, të miratuar nga ministri. Grupi i ekspertëve përbëhet nga 1 (një) specialist i METE-s, 2 (dy) specialistë nga shoqëria “Albpetrol” sh.a., 1 (një) specialist nga IQT dhe 1 (një) specialist nga AKBN.

Grupi i ekspertëve përgatit raportin për çmimin/njësi minimal fillestar të shitjes dhe e dërgon në METE dhe në shoqërinë “Albpetrol” sh.a.”.

6. Pika 8 riformulohet:

“8. Komisioni i shitjes administron të gjithë procedurën e shitjes. Komisioni do të ketë një përbërje prej 7 (shtatë) anëtarësh, përfshirë edhe kryetarin, nga të cilët 3 (tre) nga METE, 2 (dy) specialistë nga shoqëria “Albpetrol” sh.a., 1 (një) specialist do të jetë nga IQT dhe 1 (një) specialist do të jetë nga AKBN.

Anëtarët e komisionit duhet të jenë me arsim të lartë dhe së paku njëri prej tyre duhet të jetë jurist.

Ky komision është përgjegjës:

- për miratimin e dokumenteve të përgatitura nga njësia e ankandit;
- për hartimin dhe dërgimin e njoftimeve për botim brenda afateve kohore të përcaktuara në legjislacionin në fuqi për ankandin publik;
- për mbledhjen e të gjitha materialeve të nevojshme, që u bashkëlidhen dokumenteve të ankandit, duke përfshirë edhe procesverbalet e mbledhjeve;

- për llogaritjen e çmimeve të shitjes së dokumenteve të ankandit, që u jepen ofertuesve;
- për hartimin e dokumenteve të ankandit, në përputhje me këto rregulla dhe me legjislacionin në fuqi.
- për kërkesat për kualifikim dhe kriteret e vlerësimit;
- për specifikimet teknike.”.

7. Pika 9 riformulohet:

“9. Dokumentet e ankandit përgatiten nga njësia e ankandit. Gjatë procesit të hartimit të dokumenteve duhet të mbahet procesverbal, i cili nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e njësisë së ankandit.

Në hartimin e këtyre dokumenteve, njësia e ankandit duhet të përdorë dokumentet standarde të ankandit.

Në dokumentet e ankandit të përfshihen edhe:

- kërkesat për kualifikim dhe kriteret e vlerësimit;
- specifikimet teknike.

Dokumentet nënshkruhen nga të gjithë anëtarët e njësisë së ankandit, që i kanë hartuar ato.”.

8. Paragrafi i fundit i pikës 10 shfuqizohet.

9. Pika 11 riformulohet:

“11. Pas miratimit të dokumenteve të ankandit nga Komisioni i Shitjes, bëhet publikimi i procedurave të shitjes, duke i botuar ato në dy gazeta kombëtare, si dhe në faqet zyrtare të Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe/ose të shoqërisë “Albpetrol” sh.a. Patos, për 7 ditë kalendarike nga data e publikimit”.

Në këtë njoftim shënohen vendi, ora, data dhe adresa e dorëzimit dhe e hapjes së ofertave.

Në njoftim shënohet edhe se dokumentet e ankandit mund të tërhiqen në rrugë elektronike nga adresa zyrtare e Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

Në ankandin publik lejohen të marrin pjesë ofertues/kandidatë, që i kanë tërhequr dokumentet drejtpërdrejt nga komisioni i shitjes, si dhe ata, që i kanë tërhequr këto dokumente në rrugë elektronike, të cilët duhet të jenë të pajisur:

- me leje për përpunimin e produkteve hidrokarbure (naftë bruto) në tregun e brendshëm ose me licencën përkatëse të marrë në Shqipëri për tregtimin e këtyre produkteve hidrokarbure (naftë bruto), kur këto produkte do të përpunohen në Shqipëri,

- me licencën përkatëse të marrë në Shqipëri ose në vendin e origjinës së shoqërisë për tregtimin e këtyre produkteve hidrokarbure (naftë bruto), kur këto produkte do të tregtohen për qëllim eksporti*;

Ofertues/kandidatë duhet gjithashtu të plotësojnë çdo kërkesë tjetër që i shërben transparencës dhe garancisë së transaksionit të ndërmarrë, përfshirë, por pa u kufizuar në paraqitjen e:

- bilancit financiar për tri vitet e fundit ose të garancisë bankare për transaksionin financiar që do të kryejë me shoqërinë “Albpetrol” sh.a. Patos;

- ekstraktit historik dhe ekstraktit të regjistrimit të shoqërisë, nga QKR;

- dokumentit për mospasjen e asnjë detyrimi financiar ndaj shoqërisë “Albpetrol” sh.a. Patos;

- deklaratës që ofertuesi/kandidati pjesëmarrës në ankand për sasinë e naftës që do të blejë nga ankandi, nuk do të kryejë transaksione me subjekte të cilat kanë detyrime financiare ndaj shoqërisë “Albpetrol” sh.a. Patos;

- dokumentit për mospasjen e asnjë detyrimi financiar ndaj organeve tatimore dhe sigurimeve shoqërore,

si dhe çdo dokument tjetër të përcaktuar në dokumentet e ankandit, të miratuara.

Komisioni i shitjes është përgjegjës për lëshimin e një kopjeje të dokumenteve të ankandit për çdo ofertues/kandidat.

Nëse një ofertues/kandidat ankohet për hartimin e dokumenteve të ankandit apo kërkon sqarim për to, METE në çdo kohë, por jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga afati përfundimtar i dorëzimit të ofertave, në përgjigje të tyre ose me nismën e vet mund të bëjë ndryshime në dokumentet e ankandit përmes hartimit të një shtojce.

Pikë komunikimi për këto raste është METE sipas adresës së përcaktuar në dokumentet e ankandit.

Çdo shtojcë u komunikohet menjëherë me shkrim të gjithë kandidatëve që kanë tërhequr dokumentet e ankandit dhe bëhet detyruese për ta.

* Ligji nr. 8450, datë 24.2.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar.

Në çdo rast, kur ndryshohen dokumentet e ankandit, METE e zgjat afatin kohor për dorëzimin e ofertës me 5 ditë, nga data e caktuar për dorëzimin e ofertës.”.

10. Paragrafët e parë të pikës 12, deri te çështja “Informacioni i përgjithshëm përfshin:”, riformulohen: “Njësia e ankandit përgatit formatin e dokumenteve standarde të ankandit, që do të përdoren gjatë procedurave të shitjes.

Këto dokumente japin:

- (i) informacione të përgjithshme dhe
- (ii) informacion specifik, që ka lidhje me objektin e ankandit dhe llojin e procedurës, i cili plotësohet, në çdo rast, nga shoqëria “Albpetrol” sh.a. Patos. Gjatë përgatitjes së dokumenteve të ankandit, njësia e ankandit nuk duhet të përdorë asnjë dokument tjetër, përveç dokumenteve standarde.

Ato duhet të jenë gjithmonë në dispozicion të çdo ofertuesi/kandidati të interesuar, që dëshiron të marrë pjesë në këtë procedurë publike.”.

11. Në fund të shkronjës “a” të pikës 16, shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

“Gjatë negocimit të kontratës do të jetë edhe një përfaqësues i METE-s. Gjithashtu në kontratë duhet të parashikohet që afati i livrimit të mallit dhe pagesës së tij pavarësisht nga sasia që livrohet, nuk duhet të kalojë 6 (gjashtë) muaj nga data e hyrjes në fuqi të kontratës.”

12. Dispozita transitore

Për procedurat e iniciuara nga shoqëria “Albpetrol” sh.a. Patos, për të cilat është dhënë miratimi nga METE para hyrjes në fuqi të këtij urdhri, në lidhje me çmimin, sasinë dhe grupin e ekspertëve do të mbeten në fuqi dhe procedurat e mëtejshme të shitjes me ankand të naftës bruto, do të vazhdojnë të kryhen sipas dispozitave të këtij urdhri.

13. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen shoqëria “Albpetrol” sh.a. Patos, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Mbështetëse, si dhe njësia që mbulon aktivitetin hidrokarbur në METE.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I EKONOMISË, TREGTISË DHE ENERGIJE
Edmond Haxhinasto